



### KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë, 14.07.2017 (dymijë e shtatembëdhjetë), ditë e premte , përpara meje Vangjeli S. Marko, Notere në Bashkinë Gjirokastrer, regjistruar në Dhomën e Noterëve Gjirokastrë, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Enri Murto**, atësia Myrteza, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.01.1991, lindur dhe banues në Gjirokastrë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, perfaqësuar me prokure nr. 146 Rep dhe nr. 95 Kol date 10.03.2017 nga Av. Pirro Boboli me clicece nr. 3941 .(këtej e tutje referuar si “shitesi”);

nga njëra anë

*dhe*

- **Z. Dhimitraq Marku**, , i biri i Spiro dhe Valentina, lindur ne Libohove , më 24.11.1985, me banim në Sofratike Gjirokastrer, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse i kartes ID nr. I51124017R,në vijim referuar si “Pala blerese”);

nga ana tjetër

*Kushtet paraprake*

A) Shitesi është pronar i 50 pjeseve , të nënshkruar dhe të shlyer për një vlerë në para prej 50000(pesedhjetemije) Lekë që përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë “DHROPOLI - TOURS ” shpk, dhe me seli në Gjirokastrë , Shqipëri në adresë L.”18 SHTATORI” Gjirokastrer”, rregjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT 103016601D (këtej e tutje referuar edhe si “Shoqëria”);

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët e përfaqësuar ligjërisht, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë shitje të Kuotave (këtej e tutje referuar si “Kontrata”) sipas kushteve të mëposhtme:

#### **Neni 1**

##### **Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë një vullnet të shprehur të Palëve si dhe pjesë përbërëse të Kontratës.

#### **Neni 2**

##### **shitja e kuotës**

2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, shitesi shtet dhe transferon një numër prej 50 pjeseve qe perfaqesojne ne kapital 50000(pesedhjetemije) leke (në vijim referuar si “Kuotat”), të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të bleresit në menyre te barabarte i cili, siç përfaqësohet më sipër, pranon blerjen duke ndryshuar kuotat ne 0% shitesi ne kapital 0 leke (largim nga shoqëria dhe 100 % te kuotave bleresit Dhimitraq Marku, ne kapital 100000. leke

2.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, shitesi është i detyruar që të njoftojë dhe të regjistrojë këtë Kontratë pranë Shoqërisë dhe pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, bleresi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shitesit , dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë duke filluar nga viti ushtrimor në vazhdim, për të ndarë pasurinë e shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme.

#### **Neni 3**

##### **Çmimi**

3.1 Shitja e parashikuar në nenin 2.1 *supra* kryhet dhe pranohet kundrejt cmimit 50.000(pesedhjetemije) leke të deklaruar nga Palët.

3.1.1 Bleresi do të pranojë kundrejt cmimit prej 50 000 leke gjithë kuotat e shitesit.

#### **Neni 4**

##### **Deklarime dhe Garanci të dhuruesit**

4.1 Duke patur parasysh këtë kontratë shitje dhe gjendjen e Shoqërisë, shitesi , në datën e sotme, jep deklarinimet dhe garancitë e mëposhtme (këtej e tutje "Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit"):

#### 4.1.1 Gjendja Juridike dhe Autoriteti

Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në bazë të ligjit dhe akteve të shoqërisë ka të drejtë të plotë për të ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me ligjin, me aktin e themelimit dhe statutin që rregullon funksionimin e saj.

#### 4.1.2 Kapitali themeltar – Pronat e Shoqërisë – Kompetencat

- Kapitali i Shoqërisë është 100000.00 Lekë (njqind mije lekë).
- Para shitjes nëpërmjet kësaj Kontrate, shitesi Enri Murto është titullar i një numër prej 50000 leke që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë (dhe të drejtave që rrjedhin prej tyre) ,

#### 4.1.3 Regjistrat, Dokumentat Kontabël dhe Librat e Shoqërisë

- Shoqëria ka përpiluar dokumentat kontabël, regjistrat dhe librat e shoqërisë të parashikuara me ligj (këtej e tutje "Regjistrat, Dokumentat Kontabël dhe Librat e Shoqërisë"), duke përfshirë bilancin e çdo viti ushtrimor deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në mënyrë të detajuar, me qëllim reflektimin e transkuotëve në të cilën janë përfshirë aktivitetet dhe pasivitetet e saj. Përsa është në dijeni të dhuruesit (i) mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve janë thirrur dhe mbajtur rregullisht dhe për këtë qëllim janë marrë vendimet përkatëse; (ii) nënshkrimet në Regjistrat, Dokumentat Kontabël dhe Librat e Shoqërisë të sipërcituara janë nënshkrimet e personave të treguara në këto dokumenta; (iii) Regjistrat, Dokumentat Kontabël dhe Librat e Shoqërisë e sipërcituara janë azhurnuar rregullisht.


- Në ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shoqëria nuk ka debi apo pasive të ndonjë lloji, të cilët nuk janë përfshirë në Regjistrat, Dokumentat Kontabël dhe Librat e Shoqërisë.

- Shoqëria është në një gjendje të mirë financiare dhe pasurore dhe pasqyrat financiare dhe bilancet ushtrimore janë hartuar dhe depozituar pranë autoriteteve kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria ka kryer dhe depozituar rregullisht të gjitha deklaratat e kërkuara nga ligji në lidhje me taksat, tatimet, detyrimet doganore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe këto deklarime dhe përmbushje janë të vërteta dhe të sakta. Shoqëria ka derdhur brenda afateve ligjore të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore.

#### 4.1.4 Kuotat dhe titulli i shitesit

- shitesi deklaron dhe garanton se Kuotat janë emetuar në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme, janë nënshkruar dhe paguar tërësisht nga ana e tij, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe se shitesi është pronari i vetëm, legjitim dhe me fuqi të plota i Kuotave. Gjithashtu shitesi deklaron dhe garanton se Kuotat janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje, premtim shitje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve apo pretendimi nga palë të treta që mund të ndikojnë në vlefshmërinë dhe efikasitetin e kësaj Kontrate dhe të të drejtave të fituara nga bleresi në bazë të saj, pjesërisht apo tërësisht duke çliruar dhe duke mbajtur të pacënuar bleresin nga çdo kosto, shpenzim apo dëm që mund të pësojë ky i fundit.

- Shitesi deklaron dhe garanton bleresin se nuk është në dijeni të fakteve, akteve ose ngjarjeve që lidhen apo i përkasin periudhës përpara datës së lidhjes së kësaj Kontrate në ngarkim të shitesit të cilat mund të ndikojnë në efikasitetin, vlefshmërinë



dhe/ose mbi ekzekutimin e kësaj Kontrate ose që mund të sjellin efekte negative mbi bleresin apo mbi Shoqërinë, në lidhje me kosto, shpenzime dhe detyrime.

#### 4.1.5 Shkeljet, Mospërmbushjet dhe Efektet

Nënshkrimi dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate nga ana e shitesit nuk bie në kundërshtim me asnjë ligj apo akt nën-ligjor të zbatueshëm si dhe të dispozitave të Aktit të Themelimit dhe Statutit të bleresit apo të çdo marrëveshje apo mase me karakter gjyqësor të marrë ndaj tyre.

### Neni 5

#### Deklarimet dhe Garancitë e bleresit

5.1 Përsa lidhet me këtë kontratë shitje, bleresi, në datën e sotme, jep deklaratimet dhe garancitë e mëposhtme (këtej e tutje "Deklarimet dhe Garancitë e bleresit"):

##### 5.1.1 Ekzistenca dhe Autorizimet

- bleresi ka kompetencën e duhur për të lidhur dhe marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga Kontrata dhe operacionet që lidhen me të. Nënshkrimi dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate është autorizuar rregullisht, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme, në bazë të vendimeve të organeve kompetente të bleresit. Me nënshkrimin e Kontratës, bleresi, merr përsipër një detyrim të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm.

##### 5.1.2 Shkeljet, Mospërmbushjet dhe Efektet

- Nënshkrimi dhe ekzekutimi i Kontratës nga bleresi nuk bie ndesh apo nuk përbën shkelje të asnjë ligji apo akti nën-ligjor të zbatueshëm si dhe të dispozitave të Aktit të Themelimit dhe Statutit të bleresit apo të çdo marrëveshje apo mase me karakter gjyqësor të marrë ndaj tyre.

### Neni 6

#### Shpenzimet dhe taksat

Shpenzimet ligjore dhe kontabile, taksat, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të bleresit.

### Neni 7

#### Ligji i zbatueshëm dhe Gjykata Kompetente

7.1 Kjo Kontratë rregullohet nga e drejta shqiptare.

7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që lidhen me këtë Kontratë, duke përfshirë edhe ato që lidhen me vlefshmërinë, interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e saj do t'i parashtrohen për zgjidhje në mënyrë ekskluzive Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokaster.

### Neni 8

#### Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Bashkëlidhur kësaj kontrate është edhe RBS . Vendim Asambleje nr. 21 date 14-07-2017

### Neni 9 Origjinalet

Kjo kontratë është lidhur në 4 (katër) origjinalë në katër fletë, në gjuhën në gjuhën shqipe, ju lexua palëve me zë të lartë e të qartë, të cilët e kuptuan përmbajtjen edhe me perkthimin e znj. Oliana Imeri dhe meqënëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, nënshkruhet rregullisht para meje dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit. Për çdo



mosmarrëveshje që mund të lindin përsa i përket interpretimit dhe/ose ekzekutimit të kësaj Kontrate, gjuha shqipe do të jetë e detyrueshme dhe e vetme me efekte juridike për palët.



Shitësi  
perfaqësuar me prokure  
NGA AV. PIRRO BOBOLI

Av. Pirro Boboli

BLERESI

DHIMITRAK - MARKU

**NOTERE**

**Vangjeli S. MARKO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E DREJTËSISË  
 DHOMA E NOTERISË  
 GJIROKASTËR



Noter Bajram A. Aliko, me adresë: Lagjia "18 Shtatori", kati i dytë i pallatit 9-katësh përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. tel&fax:00355-08426 7199. Cel:069 22 34 125. NIPT:K32506622N.

Nr.146.Rep

Nr.95.Kol.

PROKURË E POSAÇME

Sot më datën **10 Mars 2017** (Dymijë e shtatëmbëdhjetë), ditë e premte, para meje noter **Bajram A.Aliko**, anëtar i Dhomës së Noterisë Gjirokastër, me zyrë në lagjen "18 Shtatori"-Gjirokastër, përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pallati 9-katsh, kati i dytë, u paraqit personalish dhe më kërkoi redaktimin e kësaj prokure të posaçme:

**I përfaqësuari: -Enri Murto**, atësia Myrteza, i datëlindjes 19.01.1991, lindur dhe banues në Gjirokastër, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin ID nr.personal: J10129075R, i cili deklaron:

Emëroj dhe caktoj përfaqësues të posaçëm dhe ligjor, **Av.Pirro Boboli, me licencë Nr.3941**, anëtar i Dhomës së Avokatisë Gjirokastër, me seli në Gjirokastër dhe banim në fshatin Dervician, Njësia Administrative "Dropull i Poshtëm", Bashkia Dropull, të cilit i jap të drejtë dhe kompetencë të plotë që në emrin e për llogarinë time të kryej të gjitha veprimet e duhura për shitjen e kuotave të kapitalit tim në shoqërinë "Dhropoli Tours" sh.p.k. ku unë jam aksioner me 50%.

-Të kontaktojë me blerës të mundshëm dhe të nënshkruaj në emrin e për llogarinë time kontratën e shitjes së kuotave të mia të kapitalit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

-Të paraqitet para çdo personi fizik apo juridik, para çdo zyre apo organi të administratës shtetërore në çdo nivel, që ka lidhje me kryerjen e porosisë, kërkojnë prezencën time dhe bëhen në interesin tim.

-Ai ka të drejtë të kryej veprime në QKB, Gjykata, Gjendjet Civile etj.

Kjo prokurë ka afat një vit, por mund të mbarijë më parë me mbarimin e porosisë, me heqjen dorë nga përfaqësuesi ose me revokimin nga ime me një akt noterial.

Kjo prokurë përpilohet në tri kopje me vlerë të njëjtë ligjore, lexohet me zë të lartë e të qartë, kuptohet prej tij pasi është njohur edhe me pasojat ligjore, dhe duke qenë se shpreh vullnetin e tij të lirë e të plotë, nënshkruhet rregullisht para meje dhe unë noter, duke u bazuar edhe në nenin 39 të Ligjit "Për Noterinë", e vërtetoj atë sipas ligjit.

\*\*\*\*\*

Pullat në vlerën e taksës u aplikuan në kopjen e noterit.

I PËRFAQËSUARI:

NOTER  
 BAJRAMALIKO

*Bajram Aliko*  
 10/3/17



MURTO ENRI  
*Enri Murto*